



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

QENDRA KOMBËTARE
E REGJISTRIMIT

Nr. Prot. 1010 Datë 12.10. 2015

Nr. Prot. 8993 Datë 12.10. 2015

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet

PALËVE:

KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE, (referuar si KDIMDP), përfaqësuar nga z. Besnik DERVISHI,

dhe

QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT, (referuar si QKR), përfaqësuar nga
znj. Vasilika VJERO,

të cilët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, bien dakort për sa vijon:

Neni 1
Qëllimi

Palët nënshkruese bien dakort të institucionalizojnë marrëdhëniet e tyre për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të tyre në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, veçanërisht në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Për arritjen e këtij qëllimi, bashkëpunimi i palëve do të realizohet mbi baza të njëjta dhe mbi parimin e reciprocitetit.

Neni 2
Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj marrëveshje është ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar; ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit"; ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

Neni 3 **Fushat e bashkëpunimit**

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit angazhohen që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe në mënyrë të veçantë:

1. Palët angazhohen të kërkojnë mendimet dhe sugjerimet e njëra - tjetrës në rast të hartimit të akteve të ndryshme që prekin objektin e veprimit të palës tjetër.
2. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare që i shërbejnë zbatimit të ligjeve respektive.
3. Palët angazhohen të shkëmbejnë në mënyrë të vazhdueshme njohuri dhe praktika të reja.
4. Palët angazhohen të caktojnë personat përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në ligjet respektive.

Neni 4 **Detyrimet e palëve**

Secila nga palët nënshkruese angazhohet në ndjekjen e objektivave dhe detyrimeve të kësaj marrëveshje si më poshtë vijon:

1. Të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën nëpërmjet koordinatorit për hartimin dhe rishikimin e programeve të transparencës dhe kodit të etikës. Gjithashtu, do të japin kontributin e tyre në kryerjen e sondazheve në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit.
2. Të bashkëpunojnë për hartimin, rishikimin dhe miratimin e rregulloreve e manualeve të ndryshme shpjeguese, veçanërisht për sa i përket sigurisë së të dhënave personale dhe sigurisë së informacionit.
3. QKR angazhohet të përfshijë në faqen e saj zyrtare të internetit një "*informacion njoftues*", sipas formatit të dërguar nga KDIMDP, në lidhje me detyrimin ligjor që ka çdo kontrollues për njoftim pranë këtij të fundit për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.
4. QKR angazhohet që të vendos çdo gjashtë muaj në dispozicion të KDIMDP-së, listën elektronike të përditësuar të subjekteve private të regjistruara pranë QKR-së, në të cilën përfshihet emri subjektit, nipti, objekti, forma legale, adresa fizike dhe elektronike nëse ka, nr. telefoni dhe përshkrimi.
5. QKR angazhohet që të vendosë një stendë me broshura informuese të KDIMDP-së dhe t'i orientojë subjektet për t'u njohur me broshurat sa herë që ata paraqiten pranë sporteve të QKR-së.
6. QKR angazhohet të shpallë në faqen e saj zyrtare online vendimet e Komisionerit dhënë Kontrolluesve Privat, në rastet kur këta të fundit nuk marrin dijeni mbi to.
7. Palët angazhohen të kërkojnë mendimet dhe sugjerimet e njëra-tjetrës, në rastet e nxjerrjes së rregulloreve, udhëzimeve apo amendimeve ligjore të propozuara, që prekin objektin e veprimtarisë së palës tjetër.
8. Palët angazhohen të caktojnë Personin e Ngarkuar dhe të përforcojnë rolin e tij në përputhje me udhëzimin nr. 21, datë 24.09.2012 të Komisionerit. Kooordinatori është personi përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 119/2014.

9. KDIMDP angazhohet të organizojë në ambientet e saj trajnime të dedikuara për punonjësit e QKR, për sa i përket zbatimit të legjislacionit mbi të cilin vepron KDIMDP.
10. Palët angazhohen të bëjnë të disponueshëm kundrejt kërkesave të arsyetuara dokumente /informacione të punës të konsideruar si jo konfidenciale.
11. Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të dhëna nga pala tjetër.

Neni 5 Të drejtat

Palët kanë të drejtë:

1. Të marrin pjesë në takime të grupeve të punës të organizuara nga secila palë.
2. Të marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare që i shërbejnë zbatimit të ligjeve respektive, veçanërisht, në trajnime dhe takime pune me nëpunësit e dy institucioneve dhe autoriteteve përgjegjëse.

Neni 6 Personi i kontaktit

1. Palët në zbatim të kësaj marrëveshje do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë vazhdimisht takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.

Neni 7 Dispozitat e fundit

1. Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.
2. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet me afat të pacaktuar. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse të kësaj marrëveshje.
3. Kjo marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër 15(pesëmbëdhjetë) ditë pas datës së marrjes së këtij njoftimi (ose pas datës së marrjes së tij)
4. Marrëveshja përpilohet në 4(katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe dy të tjera pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Për

**Komisionerin për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI


Për

**Qendrën Kombëtare
të Regjistrimit**

Vasilika VJERO

DREJTORI PËRGJITHSHËM
